



НАРОДНА БАНКА НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

Në mbështetje të nenit 47, paragrafi 1, pika 6 të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15 dhe 6/16) dhe nenit 65-ë, paragrafi 2 dhe 8 të Ligjit të Bankave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/07, 90/09, 67/10, 26/13, 15/15, 153/15 dhe 190/16), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë mori:

V E N D I M

për metodologjinë e përcaktimit të shumës maksimale për shpërndarjen e rezultatit të punës

("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 26/17)

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Me këtë vendim përcaktohet metodologjia e përcaktimit të shumës maksimale për shpërndarjen e rezultateve të veprimtarisë së bankave (në tekstin e mëtejme: shuma maksimale për shpërndarje) e cila përfshin:

- mënyra e përcaktimit të shumës maksimale për shpërndarje;
- mënyrën dhe përmbajtjen e raportit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: Banka Popullore);
- përmbajtjen e planit të ruajtjes së kapitalit.

2. Për termat që nuk janë përkufizuar me në këtë vendim, zbatohet kuptimi i përcaktuar me Ligjin e Bankave dhe Vendimin për metodologjinë e përcaktimit të mjaftueshmërisë së kapitalit (në tekstin e mëtejme: Metodologjia e mjaftueshmërisë së kapitalit).

II. MËNYRA E PËRCAKTIMIT TË SHUMËS MAKSIMALE PËR SHPËRNDARJE

3. Shuma maksimale për shpërndarje përcaktohet si produkt i sasisë në dispozicion për shpërndarje, e përcaktuar në përputhje me pikën 4 të këtij vendimi dhe faktorin përkatës për shpërndarje, i përcaktuar në përputhje me pikën 5 të këtij vendimi..

Banka është e detyruar të llogarisë shumën maksimale për shpërndarje, të paragrafit 1 të kësaj pike, para se të ndërmarrë ndonjë nga veprimet e mëposhtme:

- të shpërndajë rezultatin e punës që lidhet me pozicionet e kapitalit të rregullt bazë;
- të marrë përsipër detyrimin për të paguar tarifa të ndryshueshme ose të paguajë tarifa të ndryshueshme; dhe
- të kryejë pagesën në bazë të instrumenteve që janë pjesë e kapitalit bazë shtesë.

4. Shuma në dispozicion për shpërndarje fitohet kur përmbledhja e shumave nga nënpikat 1 dhe 2 të kësaj pike zvogëlohet me shumën nga nënpika 3 e kësaj pike, duke marrë parasysh dispozitat e Ligjit të Shoqërive Tregtare.

- fitimi aktual i realizuar gjatë një periudhe të caktuar kohore më të shkurtër se një vit kalendarik, i cili nuk përfshihet në llogaritjen e kapitalit bazë të rregullt të bankës në përputhje me metodologjinë e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe që është

realizuar pas marrjes së vendimit të fundit për shpërndarjen e rezultatit financiar, nga Kuvendi e bankës, ose pas ndërmarrjes së ndonjë prej veprimtarive nga pika 3, paragrafi 2 të këtij vendimi.;

- fitimi në fund të vitit, i realizuar gjatë një viti kalendarik, i cili nuk përfshihet në llogaritjen e kapitalit të rregullt bazë të bankës në përputhje me metodologjinë e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe i cili është realizuar pas marrjes së vendimit të fundit për shpërndarjen e rezultatit financiar, nga Kuvendi e bankës, ose pas ndërmarrjes së ndonjë prej veprimtarive nga pika 3, paragrafi 2 të këtij vendimi.;

- tatimin që banka do të duhej të paguante për fitimin aktual dhe/ose për fitimin në fund të vitit, nëse do të përfshiheshin në fitimin e mbajtur të pashpërndarë nga kapitali bazë i rregullt i bankës.

5. Faktori i shpërndarjes përcaktohet në bazë të shumës së kapitalit bazë të rregullt, i cili, në përputhje me Ligjin e Bankave, mund të përdoret për plotësimin e shumës totale të shtresave mbrojtëse të kapitalit (në tekstin e mëtejshëm: tepricë e kapitalit bazë të rregullt).

Faktori i shpërndarjes është:

- 0, nëse teprica e kapitalit të rregullt bazë është më e vogël ose e barabartë me 25% të shumës totale të shtresave mbrojtëse të kapitalit;

- 0,2, nëse teprica e kapitalit të rregullt bazë është më e madhe se 25%, por më e vogël ose e barabartë me 50% të shumës totale të shtresave mbrojtëse të kapitalit;

- 0,4, nëse teprica e kapitalit të rregullt bazë është më e madhe se 50%, por më e vogël ose e barabartë me 75% të shumës totale të shtresave mbrojtëse të kapitalit;

- 0,6, nëse teprica e kapitalit të rregullt bazë është më e madhe se 75%, por më pak se 100% e sasisë totale të shtresave mbrojtëse të kapitalit;

- 1, nëse teprica e kapitalit të rregullt bazë është e barabartë ose më e madhe se shuma totale e shtresave mbrojtëse të kapitalit.

III. MËNYRA DHE PËRMBAJTJA E RAPORTIT TË BANKËS POPULLORE

6. Banka detyrohet t'i paraqesë Bankës Popullore një raport për faktorin e shpërndarjes, të pikës 5 të këtij vendimi, të paktën në baza gjashtëmujore, në përputhje me të dhënat e shumës së tepricës së kapitalit bazë të rregullt me gjendjen më 30 qershorit dhe 31 dhjetorit.

7. Afati i paraqitjes së raportit të pikës 6 të këtij vendimi, me gjendjen më 30 qershor, është pesëmbëdhjetë ditë pune, ndërsa afati i paraqitjes së raportit të pikës 6 të këtij vendimi, me gjendjen më 31 dhjetor, është pesë ditë pune pas skadimit të afatit për dorëzimin e raportit financiar vjetor të parashikuar.

8. Para kryerjes së ndonjërit prej veprimeve nga pika 3, paragrafi 2 të këtij vendimi, banka është e detyruar t'i dorëzojë Bankës Popullore këto të dhëna:

- raportin e pikës 6 të këtij vendimi, të përpiluar në bazë të të dhënave të ditës së fundit të muajit, përpara dorëzimit të raportit nga kjo pikë;
- shumën në dispozicion për shpërndarje, me shënim të veçantë të shumave nga pika 4, nën pikat 1, 2 dhe 3 të këtij vendimi;
- shumën maksimale për shpërndarje, të përcaktuar në përputhje me pikën 3 të këtij vendimi;
- shumën që banka synon të shpërndajë ose të paguajë.

IV. PLAN PËR RUAJTJEN E KAPITALIT

9. Banka që nuk plotëson sasinë e përgjithshme të shtresave mbrojtëse të kapitalit është e detyruar të përgatisë planin e ruajtjes së kapitalit, të cilin ia dorëzon Bankës Popullore brenda dhjetë ditëve pas datës kur ka konstatuar që nuk i plotëson më tej sasinë totale të shtresave mbrojtëse të kapitalit.

Së bashku me planin e paragrafit 1 të kësaj pike, banka që nuk plotëson sasinë e përgjithshme të shtresave mbrojtëse të kapitalit është e detyruar që të dhënat sipas pikës 8 të këtij vendimi t'ia dorëzojë Bankës Popullore..

10. Plani i ruajtjes së kapitalit duhet t'i përgjigjet vëllimit dhe ndërlikueshmërisë së aktiviteteve të bankës.

11. Plani i ruajtjes së kapitalit duhet të përmbajë të paktën elementet e mëposhtme:

- projeksionin e të hyrave dhe shpenzimeve, si dhe pozicionet e bilancit;
- një plan me aktivitete dhe dinamika për rritjen e kapitalit të rregullt bazë për të përmbushur sasinë totale të përcaktuar të shtresave mbrojtëse të kapitalit;
- të dhëna të tjera të nevojshme për të vlerësuar përshtatshmërinë e planit të ruajtjes së kapitalit.

Banka Popullore mund të kërkojë informacione dhe të dhëna shtesë nga banka, që i konsideron të nevojshme për të vlerësuar përshtatshmërinë e planit të ruajtjes së kapitalit.

Banka është e detyruar t'i kryejë aktivitetet e parashikuara në planin e ruajtjes së kapitalit të miratuar nga Banka Popullore, në përputhje me dinamikën e paraparë.

V. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

12. Guvernatori i Bankës Popullore e përcakton me udhëzim mënyrën e zbatimit të këtij vendimi.

13. Ky vendim hyn në fuqi tetë ditë pas botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë.

O nr. 02-15/II-4/2017
27 shkurt 2017
Shkup

Guvernatori
dhe kryesuesi
i Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë
Dimitar Bogov